



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.36

2004

8 Qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.326, datë 21.5.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Beratit	2725
Vendim i KM nr.327, datë 21.5.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Gramshit	2725
Vendim i KM nr.328, datë 21.5.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Tërbuf	2726
Vendim i KM nr.329, datë 21.5.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Ngraçan	2726
Vendim i KM nr.330, datë 21.5.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fier-Shegan	2727
Vendim i KM nr.331, datë 21.5.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Allkaj.....	2727
Vendim i KM nr.332, datë 21.5.2004	Për miratimin e listës së inventarit dhe transferimin në pronësi të bashkisë së Fierit të pronave të paluajtshme shtetërore, të ish-uzinës së fermentimit të duhanit.....	2728
Vendim i KM nr.333, datë 21.5.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Ballagat.....	2728

Vendim i GJL nr.13, datë 24.3.2004	Me objekt kundërshtimin e veprimit të përmbaruesit gjyqësor dhe pikërisht të vendimit nr.46 prot., datë 5.2.2003.....	2729
Udhëzim i KQZ nr.1, datë 17.3.2004	Për hapjen e kutive të votimit dhe administrimin e dokumentacionit zgjedhor të gjendur në to pas përfundimit të zgjedhjeve.....	2734
Vendim i KKRT nr.240, datë 21.5.2004	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “TV ALPO”	2739
Vendim i KKRT nr.241, datë 21.5.2004	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “TV Channel 7”.....	2739
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Maksim Likaj....	2740

VENDIM
Nr.326, datë 21.5.2004

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË BASHKINË E BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Beratit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 279 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 3 061 (tremijë e gjashtëdhjetë e një).

2. Ndryshimet, që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.327, datë 21.5.2004

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË BASHKINË E GRAMSHIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Gramshit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 497 (katërqind e nëntëdhjetë e shtatë).

2. Ndryshimet, që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.328, datë 21.5.2004

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË KOMUNËN TËRBUF

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Tërbuf, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 133 (njëqind e tridhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 926 (nëntëqind e njëzet e gjashtë).

2. Ndryshimet, që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.329, datë 21.5.2004

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË KOMUNËN NGRAÇAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Ngraçan, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 75 (shtatëdhjetë e pesë).

2. Ndryshimet, që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.330, datë 21.5.2004

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË KOMUNËN FIER-SHEGAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Fier-Shegan, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 184 (njëqind e tetëdhjetë e katër).

2. Ndryshimet, që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.331, datë 21.5.2004

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË KOMUNËN ALLKAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Allkaj, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 227 (dyqind e njëzet e shtatë).

2. Ndryshimet, që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.332, datë 21.5.2004

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT DHE TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË SË FIERIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË ISH-
UZINËS SË FERMENTIMIT TË DUHANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 2 shkronja “c”, 3, 5, 6, 8, 9 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të ish-uzinës së fermentimit të duhanit dhe transferimin e tyre në pronësi të bashkisë së Fierit, sipas dokumentacionit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të përbërë nga formulari, planimetria dhe planvendosja.

2. Mjediset e ish-uzinës së fermentimit të duhanit të përdoren për ngritjen e një qendre publike të formimit profesional.

3. Ngarkohen Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, kryetari i bashkisë së Fierit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.333, datë 21.5.2004

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHETETËRORE NË KOMUNËN BALLAGAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Ballagat, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 32 (tridhjetë e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 102 (njëqind e dy).

2. Ndryshimet, që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.13, datë 24.3.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Zamir Poda	Anëtar
Kristaq Ngjela	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtare
Natasha Sheshi	Anëtare
Valentina Kondili	Anëtare
Evgjeni Sinoimeri	Anëtare
Irma Bala	Anëtare
Vladimir Bineri	Anëtar
Vladimir Metani	Anëtar
Ylvi Myrtja	Anëtar
Agron Lamaj	Anëtar
Bashkim Caka	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Artan Hoxha	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 24.3.2004, morën në shqyrtim çështjen civile me palë:

KËRKUES: VLASH MARINI, ADMINISTRATOR I SHOQËRISE TREGTARE "MARINI ALBPLASTIK" sh.p.k., përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi.

KUNDËR: Vendimit nr.46, datë 5.2.2003 TË ZYRËS SË PËRMBARIMIT TIRANË.

PERSON I TRETË: ZYRA E PËRMBARIMIT TIRANË, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit Shefqet Muçi.

OBJEKTI: Kundërshtim i veprimit të përmbaruesit gjyqësor dhe pikërisht të vendimit nr.46 prot., datë 5.2.2003.

Baza ligjore: Neni 610 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1290, datë 28.3.2003, vendosi:

Pranimin e kërkesës.

Anulimin e vendimit të refuzimit të urdhrit të ekzekutimit nr.46 prot., datë 5.2.2003 të Zyrës Përmbarimore Tiranë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.84, datë 5.6.2003

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit nr.1290, datë 28.3.2003 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë paraqitur rekurs Zyra e Përmbarimit Tiranë dhe Avokatura e Shtetit, të cilët kërkojnë: Zyra e Përmbarimit prishjen e tij dhe rrëzimin e kërkesës, kurse Avokatura e Shtetit prishjen e dy vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, duke parashtuar shkaqet e mëposhtme:

Në rekursin e paraqitur nga Zyra e Përmbarimit, parashtrohen këto shkaqe:

- Prona për të cilën është kërkuar ekzekutimi i titullit ekzekutiv është regjistruar në emër të shtetit shqiptar, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, e cila ka kërkuar mosekzekutimin e këtij titulli.

- Ekzekutimi do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme për investimet e bëra në objektet e njohura nga pronari.

- Vendimi nuk mund të ekzekutohet pa një zgjidhje përfundimtare të pronësisë midis dy kreditorëve solidarë, ku marrëdhëniet midis tyre janë të paqarta, pasi Vlash Marini është person fizik, ndërsa kreditori tjetër është Ministria e Ekonomisë.

- Në gjykim duhet të ishin thirrur palët ndërgjyqëse pjesëmarrëse në detyrim dhe personat e interesuar, të cilët kanë qenë edhe subjekte të veprimeve përmbarimore.

Në praktikën përmbarimore dhe gjyqësore në çdo rast janë thirrur të gjitha subjektet e interesuara në detyrim.

- Në të dyja shkallët e gjykimit janë shkelur dispozitat procedurale duke pranuar një gjykim në mungesë të Ministrisë së Ekonomisë, prania e së cilës ka qenë e domosdoshme jo vetëm si kreditor, por dhe si titullar pronësie.

- Vendimi gjyqësor që përbën edhe titullin ekzekutiv, nuk sjell detyrim për krijimin e raporteve të bashkëpronësisë së kërkuarit me shtetin.

Në rekursin e paraqitur nga Avokati i Shtetit parashtrohen këto shkaqe:

- Ekzekutimi i detyrimit nga debitori Hajredin Fratari është përmbushur. *De fakto* objektet i ka marrë në administrim njëri prej kreditorëve, ndërmarrja shtetërore “NEFINK” e më pas Ministria e Ekonomisë.

Thelbi i problemit qëndron në mosmarrëveshjen midis kreditorëve solidarë Vlash Marinit dhe Ministrisë së Ekonomisë, lidhur me raportet e pronësisë së tyre ndaj këtyre objekteve, gjë që zgjidhet me padi të veçantë midis tyre.

- Personit të tretë jo garant nuk mund t’i merren sendet që i detyrohet debitorit pa pëlqimin e tij. Gjykatat nuk kanë mbajtur parasysh kërkimet e nenit 585 të Kodit të Procedurës Civile.

Shoqëria “Doniana”, ndaj së cilës kërkon sendet Vlash Marini, është në rolin e të tretit dhe ajo ka argumentuar me dokumente shkresore, para përmbaruesit, se sendet i përkasin shtetit dhe jo Hajredin Fratarit, me të cilin është lidhur kontrata 20-vjeçare e qirasë.

Në këto rrethana, Vlash Marini, në qoftë se pretendon pronësinë mbi këto objekte, mund të kërkojë kthimin e sendit nga çdo posedues a mbajtës i tij në bazë të nenit 296 të Kodit Civil.

- Nuk është formuar drejt ndërgjyqësia.

Në vendimin që kërkohet të ekzekutohet, si palë ndërgjyqëse janë dhe AKP-ja, “NEFINK” (tani Ministria e Ekonomisë) dhe Hajredin Fratari, të cilët nuk janë trajtuar si palë ndërgjyqëse, pozitë procedurale nga e cila u lind e drejta e njoftimit dhe ankimit kundër vendimit të gjykatës.

Neni 610/2 i Kodit të Procedurës Civile nuk nënkupton përjashtimin e tyre nga procesi.

Vlash Marini nuk legjitimohet të bënte kërkesë në emër të shoqërisë “Marini-Albplastik”, sh.p.k., e cila është krijuar si person juridik në datën 18.5.2001, d.m.th. tre vjet pas dhënies së vendimit dhe një vit e gjysëm pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit.

Padia nuk është ngritur në emër të administratorit, por në emër të shoqërisë së përfaqësuar nga administratori.

Shoqëria “Marini-Albplastik” është prishur me likuidim nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.2002, datë 8.5.2003.

- Gjykata nuk ka urdhëruar njoftimin e akteve Avokaturës së Shtetit në zbatim të nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile.

Me vendimin e datës 6.1.2004, Kryetari i Gjykatës së Lartë, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim Kolegjeve të Bashkuara për efekt të njëhsimit të praktikës gjyqësore, duke parashtruar këto probleme juridike:

1. Në gjykimin e kërkesës për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore thirrja e palëve është kërkesë e detyrueshme, apo lihet në çmim të gjykatës (neni 610/2 i Kodit të Procedurës Civile)?

Në qoftë se thirrja është fakultative, atëherë çfarë duhet të ketë parasysh gjykata kur vendos thirrjen, apo mosthirrjen e palëve (kreditorit dhe debitorit)?

2. A duhet t’i njoftohet vendimi palës që nuk ka qenë në gjykim? A mund të bëjë ankim pala që nuk ka qenë në gjykim? (neni 611/2 i Kodit të Procedurës Civile)

3. A duhet të njoftohet Avokatura e Shtetit në këtë lloj gjykimi, kur njëra nga palët është shteti apo një institucion publik? (neni 79/a i Kodit të Procedurës Civile).

4. Kur vendimi gjyqësor që do të ekzekutohet përcakton dy apo më shumë kreditorë për të njëjtin objekt ekzekutimi dhe njëri kreditor kërkon ekzekutimin, ndërsa tjetri (të tjerët) e kundërshton atë, si duhet të veprojë përmbaruesi për ekzekutimin e vendimit?

5. Në rastet kur është krijuar një sh.p.k. dhe në statut përcaktohet kapitali themeltar në një shumë të caktuar në të holla, a mund të pretendojnë ortakët gjatë një konflikti eventual që në kapitalin e shoqërisë të konsiderohet se përfshihen edhe fonde të padepozituara formalisht në shoqëri, pa qenë bërë më parë përcaktimi dhe depozitimi i këtyre fondeve nga secili ortak, si dhe pa qenë vendosur shtimi i kapitalit themeltar të shoqërisë me vendim të asamblesë së ortakëve?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionet e gjyqtarëve Spiro Spiro e Bashkim Caka; përfaqësuesin e Zyrës së Përmbarimit Tiranë avokatin e shtetit Shfaqet Muçi, i cili paraqiti kërkesë alternative prishjen e dy vendimeve dhe rrëzimin e padisë, ose prishjen e dy vendimeve për shkelje procedurale dhe kthimin e çështjes për rigjykim; përfaqësuesin e kërkuarit avokat Baftjar Rusi, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Si nga Gjykata e Shkallës së Parë, ashtu edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, nuk janë zbatuar kërkesat e Kodit të Procedurës Civile për njoftimin e akteve dhe thirrjen e palëve në gjykim. Për rrjedhojë, vendimet e tyre duhet të prishen dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim.

Gjatë shqyrtimit të akteve që ndodhen në dosje, rezultoi se kërkuari Vlash Marini, me cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare “Marini Albplastik” sh.p.k., regjistruar më 18.5.2001, ka paraqitur kërkesë në gjykatë për kundërshtimin e vendimit nr.46 prot., datë 5.2.2003 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, me anën e të cilit ishte vendosur refuzimi i ekzekutimit të Urdhrit të Ekzekutimit nr.3 akti, datë 17.1.2000, lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

Ky urdhër ishte lëshuar për ekzekutimin e vendimit nr.2325, datë 10.6.1998 të po asaj gjykate, në dispozitivin e të cilit Vlash Marini, si person fizik dhe ndërmarrja shtetërore “NEFINK”, janë kreditorë solidarë, të cilëve i padituri Hajredin Fratari u detyrohej t’u kthente (të dyve), një sipërfaqe trualli prej 14.986 m², si dhe një objekt të ndërtuar mbi të.

Në vendimin e Zyrës së Përmbarimit për refuzimin e Urdhrit të Ekzekutimit, përveç të tjerave, sillet si argument fakti, që ndërmarrja shtetërore “NEFINK” është pronë e Ministrisë së Ekonomisë dhe se nga ana e kësaj Ministrie, është kërkuar mosekzekutimi i vendimit nr.2325, datë 10. 6.1998.

Me vendimin nr.1290, datë 25.3.2003, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë vendosi pranimin e kërkesës së kërkuarit Vlash Marini, duke anuluar, në të njëjtën kohë, vendimin nr.46 prot., datë 5.2.2003 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, për refuzimin e urdhrit të ekzekutimit, vendim ky, i cili u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.84, datë 5.6.2003 të saj.

Mbas shqyrtimit të shkaqeve të parashtruara në rekursin e paraqitura, Kolegjet e Bashkuara arritën në përfundimin se gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, janë lejuar shkelje procedurale, të cilat çuan në zhvillimin e një procesi jo të rregullt ligjor. Megjithatë ka qenë direkt e interesuar në zgjidhjen e çështjes, madje edhe pasi kishte bërë kërkesë për mosekzekutimin e vendimit, Ministria e Ekonomisë nuk është thirrur si palë në gjyq. Po kështu, i është mohuar Avokaturës së Shtetit, e drejta që i njeh ligji për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e shtetit në gjyq.

Nga aktet që ndodhen në dosje, rezultoi se palë të kësaj çështjeje, si në gjykatën e shkallës së parë, ashtu dhe në atë të apelit, kanë qenë Vlash Marini, (si administrator i shoqërisë tregtare “Marini Albplastik” sh.p.k.), në cilësinë e kërkuarit dhe Zyra e Përmbarimit Tiranë, vendimi i së cilës kundërshtohet, në cilësinë e personit të tretë.

Megjithatë sikundër u përmend, Ministria e Ekonomisë (pronare e pasurisë së ndërmarrjes shtetërore “NEFINK”, e cila, sipas vendimit nr.2325, datë 10.6.1998, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është në fakt kreditori i dytë solidar me Vlash Marinin për sendet që duheshin dorëzuar nga debitori) edhe pse është e interesuar direkt në këtë çështje dhe për këtë arsye kishte

korresponduar edhe me Zyrën e Përmbarrimit në fazën e ekzekutimit të vendimit, nuk është thirrur për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes, duke mos i krijuar kështu mundësi reale për të mbrojtur interesat e saj.

Është e vërtetë që thirrja e palëve në gjykimet civile me objekt kundërshtimin e veprimeve të përmbarruesit gjyqësor është fakultative dhe sikurse del nga përmbajtja e paragrafit të dytë të dispozitës së nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, lihet në çmimin e gjykatës, së cilës i jepet e drejta që kur ajo e sheh të nevojshme, t'i thërrasë ato.

Megjithatë, thirrja e palëve nuk duhet kuptuar si e drejtë e pakushtëzuar për gjykatën dhe aq më pak, si e drejtë, bazueshmëria në ligj e së cilës të mund të konsiderohet e pakontrollueshme dhe e paverifikueshme në shkallët pasardhëse të gjykimit.

Përderisa ligjvënësi ka parashikuar edhe mundësinë e thirrjes dhe pjesëmarrjes së palëve në këtë lloj gjykimi, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se gjykatës i del për detyrë që në çdo rast gjykimi të padive me objekt kundërshtimin e veprimeve të përmbarruesit gjyqësor, të mbajë parasysh edhe faktin nëse është ose jo e nevojshme, rast pas rasti, thirrja e palëve në gjykim dhe kur ajo çmon se ekzistojnë shkaqe dhe rrethana që e bëjnë të nevojshme thirrjen e tyre, sikurse në rastin objekt gjykimi, urdhëron thirrjen e tyre.

Nga ana e Kolegjeve të Bashkuara, thirrja në këtë gjykim e Ministrisë së Ekonomisë çmohet se ishte e nevojshme edhe për faktin se, sikundër u përmend, vendimi nr.2325, datë 10.6.1998, i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (për të cilin është lëshuar urdhri i ekzekutimit, zbatimi i të cilit u refuzua nga Zyra e Përmbarrimit) në dispozitivin e tij, përveç kërkesit Vlash Marini, përcakton si kreditor edhe ndërmarrjen shtetërore "NEFINK", pronare e pasurisë të së cilës është Ministria e Ekonomisë. Sendet që sipas këtij vendimi, debitori Hajredin Fratari detyrohet t'u dorëzojë të dy këtyre kreditorëve janë të njëjtat-trualli me sipërfaqe 14.986 m² dhe objekti që përshkruhet në kontratën nr.Rep.368. dhe Kol.127, datë 15.1.1997, ndërtuar mbi këtë truall, pa përcaktuar nëse që të dy këto sende do t'u dorëzohen në total të dy kreditorëve së bashku, apo secilit do t'i dorëzohen pjesë të tyre dhe në variantin e fundit, pa përcaktuar se cilat sende, pjesë ose vlerë në të holla e tyre do t'i dorëzohen secilit prej tyre, **kur dihet se që të lëshohet urdhri i ekzekutimit, është e nevojshme që vendimi gjyqësor, i cili përbën titull ekzekutiv, të përmbajë një vërtetim përfundimtar, të plotë, saktësisht të përcaktuar dhe të pakushtëzuar të detyrimit të debitorit ndaj kreditorit ose kreditorëve (kur ata janë më shumë se një, sikurse në çështjen objekt gjykimi).**

Në të kundërtën, vënia në ekzekutim e titullit ekzekutiv mund të bëhet vetëm pasi të jenë evituar ose eliminuar kufizime të tilla.

Në këto kushte dhe ndodhur përpara faktit që njëri prej kreditorëve (Ministria e Ekonomisë) kishte kërkuar mosekzekutimin e vendimit, mosthirrja e Ministrisë së Ekonomisë në gjyqin e zhvilluar kundër Zyrës së Përmbarrimit, krijon premisa për cenimin e interesave të ligjshme të saj, si kreditorë solidarë me të njëjtin vendim gjyqësor. Pikërisht ky është edhe një ndër shkaqet që, pavarësisht nga fakti që vendimi nr.1290, datë 28.3.2003, i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nuk i është njoftuar Ministrisë së Ekonomisë (as edhe ndërmarrjes shtetërore "NEFINK"), që Kolegjet e Bashkuara pranian që interesat e kësaj Ministrie, të përfaqësohen dhe mbrohen në gjykimin e zhvilluar prej tyre nga Avokati i Shtetit.

Kolegjet e Bashkuara konstatojnë gjithashtu se, as Avokaturës së Shtetit, e cila sipas ligjit nr.8851, datë 18.11.1999, ka për detyrë të përfaqësojë dhe mbrojë në gjyq shtetin, në kundërshtim me urdhërimet e dispozitës së nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile, nga ana e gjykatës, nuk ju njoftuan aktet, me qëllim që ajo të kishte mundësi të merrte pjesë në gjykim.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite (nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile), del se, kur shqyrton çështje për të cilat përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, gjykata është e detyruar që të urdhërojë njoftimin e akteve kësaj të fundit. Vetëm kështu mund t'i krijohet mundësia reale Avokaturës së Shtetit që të marrë pjesë në gjyq me qëllim përfaqësimi dhe mbrojtjeje të interesave të shtetit, në rastet e parashikuara nga ligji.

Duke qenë se shkeljet procedurale të përmendura më lart, janë të tilla që pasjellin detyrimisht prishjen e të dy vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, pretendimet e tjera të parashtruara në rekurs mund të përsëriten në atë gjykatë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 485/ç të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr.1290, datë 28.3.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr.84, datë 5.6.2003, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me trup gjykues tjetër.

Ky vendim është unifikues. Një kopje e tij të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIM I PAKICËS

Ne gjyqtarët në pakicë, kemi mendimin se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk duhet të kishin prishur vendimet e gjykatave për shkelje procedurale që lidhen me thirrjen e palëve në gjykim, por duhet të shqyrtonin dhe zgjidhjen e çështjes në themel mbi bazën e shkaqeve të ngritura në rekurs.

Siç ka rezultuar gjatë gjykimit të çështjes për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.2325, datë 10.6.1996 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është nxjerrë Urdhri i Ekzekutimit nr.3 akti, datë 17.1.2000 të lëshuar nga kjo gjykatë. Në dispozitivin e vendimit gjyqësor rezulton se Vlash Marini si person fizik dhe ndërmarrja shtetërore "NEFINK" janë kreditorë solidarë dhe i padituri Hajredin Fratari detyrohej t'u kthente atyre një sipërfaqe trualli, si dhe një objekt të ndërtuar mbi të.

Me vendimin nr.46 prot., datë 5.2.2003 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, është vendosur refuzimi i ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit të gjykatës, me arsyetimin se vendimi gjyqësor është i paqartë në dispozitivin e tij dhe se ndërmarrja shtetërore "NEFINK" është pronë e Ministrisë së Ekonomisë dhe se nga ana e kësaj Ministrie është kërkuar mosekzekutimi i vendimit gjyqësor.

Vlash Marini, me cilësinë e administratorit të shoqërisë tregtare "Marini Albplastik" sh.p.k. ka paraqitur kërkesë në gjykatë për kundërshtimin e vendimit të marrë nga ana e Zyrës së Përmbarimit.

Kolegjet e Bashkuara pranojnë si shkelje procedurale që kanë shpënë në zhvillimin e një procesi jo të rregullt ligjor faktin që Ministria e Ekonomisë, e interesuar për zgjidhjen e çështjes, e cila ka bërë edhe kërkesë për mosekzekutim të vendimit, si dhe Avokati i Shtetit, që përfaqëson dhe mbron interesat e shtetit, nuk janë thirrur si palë në gjyq.

Ashtu siç i referohet edhe shumica nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, edhe ne gjyqtarët në pakicë, kemi mendimin se **thirrja e palëve në gjykimet civile me objekt kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor është fakultative dhe sipas paragrafit të dytë të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, është në çmimin e gjykatës, e cila ka të drejtë që të thërrasë në gjykim edhe palët kur ajo e sheh të nevojshme.**

Përfundimi i mësipërm, që rrjedh nga interpretimi i dispozitës ligjore, e ka të pranueshëm edhe konkluzionin se mos thirrja e palëve në gjykim nuk duhet kuptuar si e drejtë e pakushtëzuar për gjykatën. Në të gjitha çështjet e kësaj natyre, gjykata mban parasysh faktin nëse është e nevojshme thirrja e palëve në gjykim.

Bazueshmëria në ligj e vendimit që merr gjykata, lidhur me thirrjen ose jo të palëve në gjykim, është e kontrollueshme në çdo shkallë të gjykimit brenda kufijve të kontrollit gjyqësor, në secilën shkallë që gjykohet çështja.

Por, unifikimi i praktikës gjyqësore, pranuar nga shumica, ndonëse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, qenien fakultative të thirrjes së palëve në gjykimet lidhur me kundërshtimet e

veprimeve të përmbauesit gjyqësor, e kthen në një veprim procedural të detyrueshëm për gjykatën. Në çështje të kësaj natyre palët gjithmonë mund të pretendojnë se kanë interesa të cilat u janë cenuar nga mosthirrja në gjykim dhe në këto kushte, ndodhur edhe para vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, thirrja e palëve në gjykim nuk do të ngelet fakultative, por gjykatat, pavarësisht nga çmimi që bëjnë për çdo rast, gjykimet do t'i bëjnë kurdoherë me pjesëmarrjen e palëve, sidomos kur njëra nga palët përfaqëson interesa shtetërore, në kundërshtim me përmbajtjen që ligjvënësi i ka dhënë nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile.

Përveç këtij arsytimi, vendimin e Kolegjeve të Bashkuara e vlerësojmë si të marrë në mospërputhje me nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit vendimet e gjykatave mund të ankimohen me rekurs, kur ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi), si dhe për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Në rastin në shqyrtim nuk ekzistojnë shkelje të rënda procedurale të parashikuara nga neni 467 i Kodit të Procedurës Civile dhe nga ana tjetër, mosthirrja në gjykim e Ministrisë së Ekonomisë apo e Avokatit të Shtetit, nuk mund të thuhet apriori që ka ndikuar në dhënien e vendimit gjyqësor nga Gjykata e Shkallës së Parë apo Gjykata e Apelit Tiranë.

Anëtarë: Natasha Sheshi	Valentina Kondili
Vladimir Metani	Perikli Zaharia
Bashkim Caka	Irma Bala
	Agron Lamaj

UDHËZIM

Nr.1, datë 17.3.2004

PËR HAPJEN E KUTIVE TË VOTIMIT DHE ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR TË GJENDUR NË TO PAS PËRFUNDIMIT TË ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të neneve 29 pika 1 dhe 180 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim përcakton procedurat që ndjek KQZ-ja për hapjen e kutive të votimit pas përfundimit të procesit zgjedhor, procedurat për seleksionimin, kategorizimin dhe arkivimin e dokumentacionit zgjedhor, magazinimin dhe asgjësimin e materialeve të panevojshme.

Neni 2

Hapja e kutive të votimit

Hapja e kutive të votimit bëhet me vendim të KQZ-së. Në vendimin e KQZ-së përcaktohen afatet, personat dhe shpenzimet financiare të nevojshme për këtë proces.

Neni 3

Rendi i hapjes së kutive të votimit

Hapja e kutive të votimit bëhet veçmas për çdo njësi zgjedhore.

Neni 4

Komisioni për hapjen e kutive të votimit

a) Komisioni për hapjen e kutive të votimit (KHKV) është përgjegjës për organizimin dhe kontrollin e procesit për hapjen e kutive të votimit dhe përzgjedhjen e dokumentacionit.

b) KHKV-ja përbëhet nga:

- Sekretari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	Kryetar
- Drejtori i Drejtorisë së Logjistikës	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore	Anëtar
- Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve	Anëtar
- Përgjegjësi i Zyrës së Protokoll-Arkivit	Anëtar
- Specialist i Drejtorisë Juridike	Anëtar

Neni 5

Llojet e dokumentacionit dhe materialet zgjedhore

a) Materiali që nxirret nga kutitë e votimit përbëhet nga:

- dokumentacioni për arkivim;
- materialet që mund të ripërdoren;
- materialet që do të asgjësohen.

b) Dokumentacioni për arkivim që dërgohet në Arkivin Qendror të Shtetit përfshin:

- fletoret e procesverbaleve të komisioneve zgjedhore;
- tabelat e rezultateve;
- fletoret e procesverbaleve të rinumërimit;
- lista e zgjedhësve.

c) Në materialet që mund të ripërdoren përfshihen:

- Kodi Zgjedhor;
- kuti votimi;
- tampon vule;
- llampë UV;
- bojë matrikulluese;
- materiale të tjera.

d) Në materialet që do të asgjësohen përfshihen:

- fletët e votimit;
- kundërfletët e fletëve të votimit;
- gjithë artikujt e tjerë të paklasifikuar në pikat b dhe c të këtij neni.

e) Sekretari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit për dorëzimin e materialeve që ruhen.

Neni 6

Grupet e punës

a) Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore është përgjegjëse për realizimin e procesit të hapjes së kutive të votimit.

b) Grupi i punës hap kutitë e votimit dhe grupon veçmas:

- dokumentacionin për arkivim;
- materialet që mund të ripërdoren;
- materialet që do të asgjësohen.

c) GP-ja mban procesverbal për materialet e gjetura në kuti për çdo qendër votimi, sipas lidhjes 1. Në përfundim të hapjes së kutive të votimit të një njësie zgjedhore, GP-ja harton një procesverbal sipas lidhjes 2. Këto procesverbale nënshkruhen edhe nga Drejtori i Drejtorisë së Logjistikës Zgjedhore.

d) Procesverbalet e hartuara për çdo njësi zgjedhore depozitohen pranë arkivës së KQZ-së.

Neni 7

Përpunimi i dokumentacionit dhe i materialeve zgjedhore

- a) Dokumentacioni për arkivim, sipas përcaktimit të nenit 4/b, dërgohet në Arkivin Qendror të Shtetit.
- b) Materialet që mund të ripërdoren magazinohen pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- c) Të gjitha materialet e tjera, të cilat gjenden në kutitë e votimit, ambalazhohen dhe asgjësohen nëpërmjet djegies.

Neni 8

Asgjësimi i materialeve

Asgjësimi i materialeve, sipas pikës 7/c të këtij udhëzimi, bëhet me procesverbal, në prezencë të KHKV-së.

Neni 9

Raportimi

Në përfundim të procesit të hapjes së kutive të votimit, KHKV-ja i paraqet KQZ-së një raport.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Lidhja 1

Per: Verifikimin e dokumentacionit dhe bazes materiale te riperdorshme te gjetur brenda kutise se votimit		 Proçes Verbal PV Nr: KQZ/DL/04/ _____ Date: ____/____/____ <i>Pas hapjes se kutise se votimit, u gjet dhe e perzgjodh dokumentacioni dhe materialet e meposhtme</i>		
Baza Ligjore: NENI 180/6 I LIGJIT NR.9087, DATË 19.06.2003 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"				
NJESIA ZGJEDHORE _____	QARKU _____	QENDRA E VOTIMIT NR. _____		
Dokumentacion:				
Nr.	Emertimi	PO	JO	
1.	Tabele e rezultateve te KQV			
2.	Fletore proces-verbali e Komisionit			
3.	Fletore proces-verbali e rinumerimit			
4.	Lista e zgjedhesve e QV-se			
Baze materiale e riperdorshme:				
Nr.	Emertimi	PO	Sasia	JO
1.	Kod Zgjedhor	cope		
2.	Kuti votimi	cope		
3.	Tampon vule	cope		
4.	Llampe UV	cope		
5.	Boje matrikuluese	shishe		
6.	Vizore	cope		
7.				
8.				
9.				
10				
Vertetoi per grupin e punes: Emer/Mbiemer: _____ Firma: _____		Sigloi: Per Drejtorine e Logjistikes _____ (Emer, Mbiemer, Firme)		



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Lidhja 2

Per: <u>Verifikimin e dokumentacionit dhe bazes materiale te riperdorshme te gjetur brenda kutive te votimit te njesise zgjedhore</u>		Proces Verbal PV Nr: KQZ/DL/04/ _____ Date: ____/____/____ <i>Pas hapjes se kutive te votimit te njesise zgjedhore, u gjet dhe e perzgjodh dokumentacioni dhe materialet e meposhtme:</i>	
Baza Ligjore: NENI 180/6 I LIGJIT NR.9087, DATE 19.06.2003 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE"			
NJESIA ZGJEDHORE _____	QARKU _____	NUMRI I QENDRAVE TE VOTIMIT BRENDA NJESISE _____	
Dokumentacion:			
Nr.	Emertimi	Sasia	Verejtje
1.	Tabele e rezultateve te KQV		
2.	Fletore proces-verbali e Komisionit		
3.	Fletore proces-verbali e rinumerimit		
4.	Lista e zgjedhesve e QV-se		
Baze materiale e riperdorshme:			
Nr.	Emertimi	Sasia	Verejtje
1.	Kod Zgjedhor		
2.	Kuti votimi		
3.	Tampon vule		
4.	Llampe UV		
5.	Boje matrikuluese		
6.	Vizore		
7.			
8.			
9.			
10			
Vertetoi per grupin e punes: Emer/Mbiemer: _____ Firma: _____		Sigloi: Per Drejtorine e Logjistikes _____ (Emer, Mbiemer, Firme)	

VENDIM
Nr.240, datë 21.5.2004

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“TV ALPO”

SUBJEKT: Z. ARISTOTEL PETRO

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar në vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, Z. Aristotel Petro, me vendndodhje në qytetin e Gjirokastrës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca e bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
Nr.241, datë 21.5.2004

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“TV CHANNEL 7”

SUBJEKTI: ZNJ. ORJANA CENKO

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radiotelevizive”, të miratuar në vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, Znj. Orjana Cenko, me vendndodhje në qytetin e Gjirokastrës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca e bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Sefedin Çela

KËRKESE

Shtetësja Tushe Likaj, lindur dhe banuese në Elbasan, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasit Maksim Halit Likaj.

KËRKUESE
Tushe Likaj

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

SË SHPEJTI NË BOTIM:
INDEKSI TEMATIK DHE KRONOLOGJIK
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

Doli nga shtypi më 8.6.2004

Tirazhi: 4500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë